



**VENDIM**

***Nr.78 Datë 23.10.2009***

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“MALIDO ENERGJI” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 dhe neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.10.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k., për t`u licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

**Dhe konstatoi se:**

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronesor (neni 9, pika 2)
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)
- Dokumentacionin teknik (neni 9, pika 4)

**Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:**

- Mosplotësimin e lejes për piken e lidhjes me sistemin elektroenergjetik (neni 9, pika 4.1.5, pika “a”), pasi aplikuesi është në proces negociimi me OSSH sh.a dhe DPR për t`u lidhur në rrjetin 20 kV ne N/st i cili furnizon me energji elektrike Tunelin e Kalimashit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar:

**Vendosi:**

1. Miratimin e licensimit të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “KLOS”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIM**

*Nr.78 Datë 23.10.2009*

**PËR**  
**LICENSIMIN E SHOQËRISË**  
**“MALIDO ENERGJI” SH.P.K.**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkelqim Bozgo</b>	_____	_____